

VENDIM
Nr. 4, datë 4.2.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 39, DATË 16.10.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, "PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE NR. 18, DATË 19.11.2014, NR. 5, DATË 9.2.2015, DHE NR. 22, DATË 8.5.2015"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e fondit për programin e infrastrukturës vendore dhe rajonale, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 18, datë 19.11.2014, nr. 5, datë 9.2.2015, dhe nr. 22, datë 8.5.2015", bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projekti nr. 3, në tabelën 1 të këtij vendimi, ndryshon, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e kontratës (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
	QARKU ELBASAN				
3	Bashkia Elbasan	Sistemim - asfaltim i rrugëve “Sul Misiri” dhe “Fehmi Kotherja”	73,933,175	16,473,074	57,460,101
4	Bashkia Elbasan	Sistemim - asfaltim i rrugës “25 Nëntori”	90,797,561	16,473,074	74,324,488

Shënim:

Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1 të këtij vendimi, ndryshon: nga 31 projekte bëhet 32 projekte. Rinumërimi i projekteve fillon tek projekti 4, deri në numrin rendor nr. 32.